

SHFK "IMRI ELEZI"- ÇAIR, SHKUP

PROGRAMI VJETOR

i veprimtarive edukativo-arsimore për vitin shkollor 2024/2025



Gusht 2024

PËRMBAJTJA

1. Hyrje

- Bazat hyrëse për përpunimin e programës vjetore
- Rregullativa ligjore

2. Letërnjoftmi i shkollës

- Të dhëna themelore për shkollën
- Kushtet hapësinore për punën e shkollës
- Kushtet materijalo - teknike
- Struktura e shkollës
- Hapësirat mësimore
- Hapësirat për veprimtari shoqërore dhe pedagogjike:
- Hapësirat për nevojat shëndetësore dhe sanitare dhe hapësirat tjera ndihmëse
- Oborri shkollor dhe hapësira tjera
- Kuadri arsimor
- Numri i nxënësve dhe paraleleve
- Gjuha mësimore
- Të punësuar tjerë në shkollë
- Udhëheqës të paraleleve
- Pasqyra e kuadrit edukativo – arsimor me orë

3. Misioni dhe vizioni

4. „Lessons Learned“ – Tanimë e mësuar / Përvojat e arritura

5. Lëmitë e ndryshimeve , prioritete dhe qëllime

- Motoja e shkollës
- Lista e prioriteteve të caktuara

6. Planet akcionale

7. Plan për evaluimin e planeve akcionale

8. Kalendar për vitin Shkollor 2024/2025

- Ditë pune
- Ditë jopune
- Eko kalendari

9. Mësimi dhe të nxënit

- Lloji i mësimimit
- Organizimi i mësimimit të obliguar
- Mësimi zgjedhor
- Mësimi plotësues dhe shtues
- Program për punë me nxënës të talentuar dhe të prirur
- Program i individualizuar për fëmijët me nevoja të posaçme arsimore
- Lidhja e programës ekologjike me mësimin e rregullt
- Përdorimi i TIK – ut në mësim

10 . Notimi

- Ekipi për analizë , përcjellje dhe përkrahje

11. Aktivitetet jashtëmësimore

- aktivitetet e lira të nxënësve dhe sekcionet
- garat e nxënësve
- puna shoqërore humanitare

12. Përkrahja e nxënësve

- Plani dhe programi i KK
- Organizata e fëmijëve
- Parlamenti i nxënësve
- Mbrojtja dhe shpëtimi
- Orientimi profesional i nxënësve

13. Kujdesi për shëndetin

14. Klima shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë

- Preventivë nga dhuna
- Multikulturalizmi

15. Zhvillim profesional i kuadrit arsimor

- Programi për punën e EPTN
- Aktivitetet profesionale
- Evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik
- Kontrollimi i programeve vjetore të arsimtarëve
- Programi për ekskurzionet
- Puna ekipore

16. Këqja e familjes në shkollë

- Bashkëpunimi me familjen

17. Komunikimi publik dhe promovimi i shkollës

- Bashkëpunimi me vetëqeverisjen lokale dhe ndërrmarjet në rrethinë
- Bashkëpunimi i shkollës me institucionet edukativo-arsimore nga lëmia e kulturës, ekonomisë dhe organizatat tjera

1.HYRJE

Elementet kryesore për përpilimin e planeve

Programi vjetor për punën në shkollë do të thotë plan operativ ku është e përfshirë e gjithë puna në shkollë . Ky dokument na udhëzon për realizimin e planeve globale dhe aktiviteteve dhe i paraprijnë të gjitha format dhe mundësitë për punë materialisht, teknikisht dhe financiarisht që kur egziston shkolla. Planifikimi i të gjitha aktiviteteve gjatë këtij viti shkollor i përfshirë në Planin vjetor, është shumë i rëndësishëm për realizimin e suksesshëm të procesit edukativo – arsimor dhe jetën në përgjithësi në shkollë.

Regullativa ligjore

- Ligji për arsim fillor në RMV;
- Statuti i SHFK,,IMRI ELEZI,,
- Planet dhe programet mësimore sipas lëndëve dhe lëmive mësimore;
- Kriteriumet dhe standardet për notimin e arsimit fillor;
- Doracak “Arsimi Fillor - përmbajtja dhe organizimi i procesit edukativo – arsimor ;
- Vetëevaluimi i Shkollës
- Plani për arritjet e shkollës
- Të dhënat për punën e shkollës në vitin e kaluar
- Analiza e punës të vitit shkollor 2023/2024
- Dokumente dhe akte të MASH
- Kuadri dhe kushtet materijale për punën e shkollës
- Qasja bashkohore për zhvillim të arsimit
- Njohuritë e fituara nga zhvillimi profesional i kuadrit arsimor si dhe bashkëpunëtorëve profesional;
- Njohuritë më të reja nga trajnimet dhe seminarët ,literatura pedagogjike dhe praktika;
- Koncepti për arsim nëntëvjeçarë;
- Bashkëpunimi me shkollat tjera;
- Bashkëpunimi me BZHA, ISHA etj.

1. Letërnjoftimi i shkollës

Të dhënat e përgjithshme për shkollën

Shkolla fillore komunale “**Imri Elezi**” është e themeluar me vendimin Nr. **07–32/61** më **01.02.1980**, e verifikuar me vendimin Nr . **10–372/3** më **12.04.1995** në Komitetin komunal për arsim, kulturë dhe kulturë fizike e Këshillit të komunës Çair - Shkup. Veprimtaria themelore e shkollës është edukimi dhe arsimimi i nxënësve nga klasa e parë gjer në klasën e nëntë në funksion të krijimit të qëllimeve dhe detyrave themelore të arsimit.

Shkolla “**Imri Elezi**” gjendet në komunën e Çairit në rr.”Braça Rexhepagiq, nr.29 – Lagja Dizhon – Shkup . Ndërtesa është ndërtuar në vitin 1979 nga ndërtimi i fortë dhe i përgjigjet qëllimit për të cilin është ndërtuar. Sipërfaqja e objektit është 4900 m², ndërsa sipërfaqja e oborrit të shkollës është 5200 m².

Në oborrin e shkollës gjenden 17 ndërtime të egra . Nxemja është personale me kazanët e nxemjes me naftë. Gjatë vitit shkollor 2022/2023 me qëllim të efikasitetit energjetik (energjia elektrike dhe ngrohja e ujit), është realizuar Projekti CBCECOkiD, që është pjesë e “ IPA II Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Kosovë - Maqedoni e Veriut 2014 – 2020 i financuar dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatuar nga Komuna e Ferizajt në partneritet me Komunën e Çairit në Maqedoninë e Veriut dhe Organizata joqeveritare lokale “ Qendra për Mbështetje të Biznesit në Kosovë – BSCK “. Qëllimi kryesor i këtij projekti është zona e Programit Ndërkufitar që përfiton nga zbatimi i standardeve dhe vlerave të mbrojtjes së mjedisit. Andaj në bazë të Kontratës për shitëblerje të centralit fotovoltaiq, më 04.05.2023 është bërë edhe pranimdorëzimi dhe është lëshuar në përdorim sistemi fotovoltaiq. Gjatë këtij procesi u realizuan një sërë aktivitete dhe punëtori ku morrën pjesë nxënës dhe mësues nga dy palët partnere të këtij projekti. Përrurimi u bë më 13 qershor 2023 në hapësirat e shfk “ Liria “ në Çair. Problem paraqet rrjeti i kanalizimit i cili nuk ka rrëshqitje kah shahtat e shkollës dhe gjatë kohës me të rreshura hapsirat në bodrume mbushen me ujë. Hapsira për evaukim është e papërdorshme sepse nuk ka ventilim .

Oborri përdoret si kalim rrugor për banorë lokal , sepse nuk ka rrugëdalje tjetër.

Në shkollën “**Imri Elezi**” – puna edukativo arsimore realizohet në **20** paralele nga kl. **I-V**, me mësim në gjuhën shqipe. Nga kl. **VI-IX**, ka **13** paralele.

Shkolla në kontinuitet merr pjesë në numër të madh të konkurseve: letrare , të artit etj (komunale , shtetërore dhe olimpiada) sipas lëndëve dhe lëmive të ndryshme.

Për çdo mund dhe për çdo të arritur nxënësit fitojnë dhurata , diploma , mirënjohje, faleminderime , plaketa , statueta , etj.

Aktivitetet lidhur me zgjerimin e diturive përbushen përmes realizimit të garave nga lloji , ndërklasor , komunal , regional dhe shtetëror.

SHFK” Imri Elezi” në vitin shkollor 2024/25 funksionin e saj shoqëror dhe pedagogjik do ta realizojë sipas Ligjit për arsim fillor dhe të gjitha dokumentet tjera të cilat janë të lidhura me arsimin fillor.

Emri i shkollës	Shkolla fillore komunale “Imri Elezi”
adresa, komuna, vendi	rr. Braça Rexepaqiq, nr. 29, lagja e Dizhonit – Çair, Shkup
telefon	02 2 62 26 75
fax	02 2 62 26 75
e-mail	ou-imrielezi-chair@schools.mk; shkimrielezi@hotmail.com
E themeluar nga	Ministria e arsimit dhe shkencës, Vendimi nr. 07–32/61 prej 01.02.1980
Verifikimi – nr.i aktit	nr. 10–372/3
Viti i verifikimit	12.04.1995
Gjuha mësimore	Shqipe / maqedone
Viti i ndërtimit	1979
Lloji i ndërtimit	Ndërtimi i fortë dhe i pergjigjet qellimit për të cilin është ndërtuar
Sipërfaqja e objektit	4900 m ²
Sipërfaqja e oborrit të shkollës	5200 m ²
Sipërfaqja e tereneve dhe sallave sportive	1000 m ²
Shkolla punon në ndrrime	Në ndrrime
Mënyra e ngrohjes së shkollës	Nxemja është vetanake me kazanë të nxemjes me naftë
Numri i klasave	I-IX
Numri i paraleleve	33
Numri i ndrrimeve	Dy ndrrime
Statusi i eko-shkollës (flamuri i gjelbërt, i argjendtë ose niveli i bronzë)	/
Data e statusit të fituar	/


Kushtet hapsinore për punën e shkollës

Numri i përgjithëm i ndërtesave shkollore	1
Numri i shkollave periferike	/
Sipërfaqja bruto	8200 m ²
Sipërfaqja neto	4900 m ²
Numri i tereneve sportive	1
Numri i kateve	Përdhese + kat
Numri i klasave	23
Numri i hapsirave ndihmëse	13
Biblioteka e shkollës	1
Mënyra e ngrohjes së shkollës	Me naftë (vetanake)

Kushtet materiale - teknike

Llojet e mjeteve	Disponon me numër
Piano	1
TV- aparate	2
Printues	6
Fotokopir	2
Kompjutorë	7
Llogaritës	2
Lap-top për arsimtarët	2
Tabletë për nxënësit	0
CD-kasetofon	6
DVD	0
Mikroskop	3
Aparatë multifunkcionale	1
Video-projektor	3
Kompjutorë për nxënësit	0
Monitore	15


KATI I POSHTËM



W




W



W





Struktura e shkollës

Anëtarë të Këshillit të shkollës	Arta S. Akteshi- Këshilli arsimor Emine Ramuka - Këshilli arsimor Metush Memedi - Këshilli arsimor Llokman Shaqiri - Këshilli i prindërve Musa Baku - Këshilli i prindërve Izair Neziri- Këshilli i prindërve Qamuran Ismaili – Vetëqeverisja lokale - Parlamenti i nxënësve - Parlamenti i nxënësve
Anëtarë të këshillit të prindërve	33
Aktive profesionale	- aktivi i mësimdhënësve të mësimit klasor; - aktivi i mësimdhënësve të mësimit lëndor
Këshilli arsimor (numri i mësimdhënësve)	60
Anëtarët e Parlamentit të nxënësve	13
Anëtarë të Eko - Këshillit	13

1. Hapësirat mësimore:

Nr. rend.	Lloji I hapësirës	Numri
1.	Klasa (kabinete)	23
2.	Kabineti i arsimit teknik / Kabineti i informatikës	1
3.	Kabineti i shkencave natyrore	1
4.	Kabineti i arsimit figurativ	1
5.	Kabineti i arsimit muzikor	1
6.	Hapësira për mjete mësimore	7
7.	Biblioteka	1

2. Hapësirat për lëmi shoqërore dhe pedagogjike:

Nr. rend.	Lloji I hapësirës	Numri
1.	Hapësira për arsimtarë dhe drejtor	2
2.	Hapësira për bashkëpunorët profesional	1
3.	Hapësira për punë administrative	2

3. Hapsira për nevoja shëndetësore, sanitare dhe hapsira ndihmëse

Nr. rend.	Lloji i hapësirave	Numri
1.	Korridoret dhe shkallët	12
2.	Nyjet sanitare	10
3.	Magazina	2
4.	Hapësirat tjera	2

Oborri i shkollës dhe sipërfaqet tjera:

Nr. rend.	Lloji i hapësirave	Numri
1.	Fusha sportive	1
2.	Parku i shkollës	1

Kuadri arsimor

	Gjithsej	Struktura etnike dhe gjinore e të punësuarve									
		maqedon		Shqiptar		Turk		Rom		E tjerë	
		M	f	M	f	M	f	M	f	M	f
Numri i të punësuarit	79		4	22	53						
Numri i kuadrit arsimor	60		2	16	42						
Numri i bashkëpunorëve profesional	4				4						
Punëtor administrative	3			2	1						
Personeli teknik	11		2	4	5						
Drejtor	1				1						

Niveli i arsimimit të të punësuarve

Arsimim	Numri i punëtorëve
Arsimim superior	57
Arsimim i lartë	5
Arsimim i mesëm	10
Arsimim fillor	7

Struktura e moshës së të punësuarve

Mosha	Numri i të punësuarve
20-30	11
31-40	11
41-50	25
51-60	30
61-64	2

Gjuha mësimore

	Gj. maqedone	Gj. shqipe
Numri i paraleleve	/	33
Numri i nxënësve	/	919
Numri i mësimdhënësve	/	60

Numri i nxënësve dhe paralelet

Klasa	Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve	Struktura etnike dhe gjinore e nxënësve									
			Maqedon		Shqiptar		Turq		Rom		Boshnjak	
			m	f	m	f	m	f	m	f	m	f
I	5	139			74	65					/	/
II	4	101			50	51					/	/
III	3	92			53	39					/	/
IV	5	118			55	63					/	/
V	3	79			42	37					/	/
I – V	20	529			274	255					/	/
VI	4	106			58	48					/	/
VII	3	83			40	43					/	/
VIII	3	82			46	36					/	/
IX	5	109			57	50					2	/
VI – IX	15	380			201	177					2	/
I – IX	35	909			475	432					2	/

Të punësuar të tjerë në shkollë

Emri dhe mbiemri	Vendi i punës
Xhelazim Ibraimi	Sekretar
Ramiz Dema	Nikoqir
Refik Bruti	Hausmjeshtër
Enver Kashtanjeva	Drejtues i nxemjes
Pajazit Toçi	Kontabilist
Alma Tahiri	Arkatare
Skender Abazi	Mbajtës i higjienës
Sonja Kunovska	Mbajtës i higjienës
Tatjana Vellkovska	Mbajtës i higjienës
Mukades Fejzullai	Mbajtës i higjienës
Ajser Точи	Mbajtës i higjienës
Remzije Islami	Mbajtës i higjienës
Taire Maliqi	Mbajtës i higjienës
Fatime Limani	Mbajtës i higjienës

Udhëheqës të paraleleve

Num. Rend.	Emri dhe mbiemri i mësimitdhënësit (udhëheqës klase)	Klasa
1.	Arjeta Çajlani //	I -1
2	Arta S. Akteshi	I -2
3.	Arbana Vojka	I -3
4.	Hanife Zenuni / Vildan Zejneli	II -1
5.	Luljeta Kiki	II -2
6.	Fuada Adili	II -3
7.	Zekije Mexhiti	II -4
8.	Naziktere Amiti / Melek Asani	III-1
9.	Zemrije Jusufi	III-2
10.	Ajnur Aliju	III-3
11.	Ferihan Loku	III-4
12.	Luljeta Aliu	IV -1
13.	Meral Tairi	IV -2
14.	Blerina Daci	IV -3
15.	Majlinda Curri	IV -4
16.	Fatmire Ramadani	V -1
17.	Drandofile Rudi	V-2
18.	Sejlan Shaqiri	V-3
19.	Shkendije Imeri	V-4
20.	Nertila P. Vejseli	V-5
21.	Emine Ramuka	VI-1
22.	Halim Jashari	VI-2
23.	Emine Isen	VI-3
24.	Sumeja Beqiri	VII-1
25.	Fatmire Meca	VII-2
26.	Eugen Muça	VII -3
27.	Irjeta Isaki	VII -4
28.	Fakete Fetai	VIII-1
29.	Medina Latifi	VIII-2
30.	Nazlije Dibrani	VIII -3

31.	//	IX - 1
32.	Abedin Zharku	IX - 2
33.	Gëzime Fazli	IX - 3

Pasqyrë e orëve të kuadrit edukativo - arsimor
Fondi javor i orëve të mësimdhënësve klasor dhe lëndor në paralele

Nr. Rend.	Emri dhe mbiemri i mësimdhënësit	Lëndët obligative	Nr. i orëve	Lëndët zgjedhore	Aktivitete tjera	Udhëheqës të paraleleve	Gjithsej orë	Orë bashkësie
1.	Arjeta Çajlani //	Klasor	23	1	-	I -1	24	-
2.	Arta S. Akteshi	Klasor	23	1	-	I -2	24	-
3.	Arbana Vojka	Klasor	23	1	-	I-3	24	-
4.	Hanife Zenuni / Vildan Zejneli	Klasor	23	1	-	II-1	24	1
5.	Luljeta Kiki	Klasor	23	1	2	II-2	25	1
6.	Fuada Adili	Klasor	23	1	2	II-3	25	1
7.	Zekije Mexhiti	Klasor	23	1	2	II-4	25	1
8.	Naziktere Amiti / Melek Asani	Klasor	23	1	2	III-1	25	1
9.	Zemrije Jusufi	Klasor	26	1	2	III-2	29	1
10.	Ajnur Aliju	Klasor	26	1	2	III-3	29	1
11.	Ferihan Loku	Klasor	26	1	2	III-4	29	1
12.	Luljeta Aliu /	Klasor	26	1	2	IV -1	29	1
13.	Meral Tairi	Klasor	26	1	2	IV-2	32	1
14.	Blerina D. Iseni	Klasor	29	1	2	IV-3	32	1
15.	Majlinda Curri	Klasor	29	1	2	IV-4	32	1
16.	Fatmire Ramadani	Klasor	29	1	2	V-1	32	1
17.	Drandofile Rudi	Klasor	29	1	2	V -2	32	1
18.	Sejlan Shaqiri	Klasor	30	1	1	V-3	32	1
19.	Shkendije Imeri	Klasor	30	1	1	IV-4	32	1

20.	Nertila P. Vejseli	Klasor	30	1	1	IV-5	32	1
21.	Emine Ramuka	Gjuhë shqipe VI-1,2,; VII-1,2,3	20	/		VI-1	20	1
22.	Emine Iseni	Gjuhë Shqipe VI-3;VII -1,2,3; IX -3	20	/		VI-3	20	1
23.	Irjeta Isaki	Gjuhë Shqipe VII - 4; IX-1,2	12	Lojra për zgjidhjen e konflikteve / Kam të drejtë VII-1,2,3,4	8	VII-4	20	1
24.	Elena Stojmenovska	Gjuhë maqedone VII- 1,2,3,4;IX- 1,2,3; VI-1,2,3	20	/	-	-	20	-
25.	Gzime F. Bislimi	Gjuhë maqedone VI-1,2,3,4; IX- 1,2,3,	14	Përmisimi I shëndetit IX-1,2,3	6	IX-3	20	1
26.	Suela Imeri	Gjuhë maqedone IV-1,2,3,; V-4	8	Poezi/ Teatri aftësi I emocioneve IV-1,2,3	6	-	14	-
27.	///	Gjuhë angleze VIII-1,2,3; IX-1,2,3 II-1 III-1	22	/	-	IX-1	22	1
28.	Jeton Rashiti	Gjuhë angleze VI-1,2,3 VII-1,2,3,4	21	/	-	-	21	-
29.	Shehide Ibrahimimi	Gjuhë angleze I-1,2,3; IV-1,3; V-,2,4,5	21	/	-	-	21	-
30.	Sherife Sali	Gjuhë angleze II-2,3,4,5, III-2,3,4; IV-2; V-1,3	23	/	-	-	23	-
31.	Ana Markovska	-	-	-	Administratore e shkollës	-	8	-

32.	Nazlije Dibrani	Gj. Gjermane VI-2, VII-1,2,3,4 VIII-1,2,3; IX-1,2,3,	22	-	-	VIII-3	22	1
33.	Drita Zeqiri	Gj. gjermane VI-1,3	4	/	-	-	4	-
34.	Sevgyl Çilafi	Matematik VI-1,2; IX-1,2,3	22	/	-	-	22	-
35.	Fatmire Meça	Matematika VI-,3 VII-1,2,3,4	21	/	-	VII-2	21	1
36.	Medina Latifi	Matematik VIII-1,2,3; IX-3,4	12	/	-	VIII-2	12	1
37.	Halim Jashari	Biologji VIII-1,2,3; IX-1,2,3, Shkenca natyrore (moduli-Biologji) VII-1,2,3,4	20	/	-	VI-2	20	1
38.	Faton Curri	Shkenca natyrore (modul Fizik) VII-1,2,3,4; Shkenca natyrore (modul Kimi) VII-1,2,3,4; Kimi VIII-1,2,3 IX-1,2,3	20	/	-	-	20	-
39.	Sumeja Beqiri	Fizik VIII-1,2,3 IX-1,2,3, Shkenca natyrore VI-1	15	/	-	VII-1	15	1
40.	//	Histori VIII-1,2,3; IX-1,2,3;	20	-	-	-	20	

		Histori dhe shoqëri (modul Histori) VII-1,2,3,4						
41.	Metush Memedi	Histori dhe shoqëri (modul Histori+arsim qytetar) VI-1,2,3 Arsim qytetar VIII-1,2,3	12	Etika e religjionit VI-1,2,3, Shkathtësi për jetë VIII-3	8	-	20	-
42.	Blerta Limani	Histori dhe shoqëri ,(moduli/ gjeografi)VI-1,2,3 Shkenca natyrore VI-2,3	9	-	-	-	9	-
43.	Eugen Muça	Gjeografi VIII-1,2,3; IX-1,2,3 Histori dhe shoqëri (moduli/ gjeografi) VI-1,2,3,4	20	/	-	VII-3	20	1
44.	Fakete Fetai	Inovacion IX-1,2,3, Arsim teknik me informatik VI-1,2,3 VII-1,2,3,4	17	Lëndë zgjedhore Programim VIII-1,2	4	VIII-1	21	1
45.	Isuf Jusufi	Arsim teknik me informatik IV-1,2,3 V-1,2,3,4,5	13	Arsim teknik IX-1,2,3 Përpunimi I letrës /Ndihma e parë V-2	8	-	21	-
46.	Nehat Curri	Arsim muzikor VI-1,2,3, VII-1,2,3,4	7	Lëndë zgjedhore Muzik popullore/Shah V-1,3,4,5	8	-	15	-

47	Veton Curri	Arsim muzikor VIII-1,2,3; IX-1,2,3	6	Kori dhe orkestri 3+3	-	-	12	-
48.	Orhan Emrovski	Arsim figurativ VI-1,2,3;; VII-1,2,3,4 VIII-1,2,3; IX-1,2,3	13	/	-	-	13	-
49.	Sabri Ramadani	Arsim fizik dhe shëndetësor VI-1,2,3; VIII-1,2,3 III-1	21	/	-	-	21	-
50.	Abedin Zharku	Arsim fizik dhe shëndetësor VII-1,2,3,4 IX-1,2,3	21	/	-	IX-2	21	1
51.	Valon Rogaçi	Arsim fizik dhe shëndetsor I-1,2; V-1,2,3,4,5	21	/	-	-	21	-
52.	Vjollca Rexhepi	Shkenca natyrore V-1,2,3,4,5;	10	/	-	-	10	-
53.	Enes Arif	Arsim fizik dhe shëndetsor I-3; II-1,2,3,4,5; III-4	21	/	-	-	21	-
54.	Diellza Hamiti	Arsim fizik dhe shëndetsor III-2,3 IV-1,2,3	15	/	-	-	15	-

1. MISIONI

Shkolla jonë si mjedis multietnik synon kah sigurimi i standardeve më bashkëkohore për edukim të nxënësve dhe zhvillimin e tyre në personalitete komplete të përkatësisë së tyre etnike. Duam të ndërtojmë klimë të këndshme të besimit reciprok midis nxënësve, mësimitdhënësve, prindërve dhe bashkësisë lokale.

Ne jemi mjedis i individëve të vetëdijshëm, parimor, kulturor dhe të virtytshëm dhe ndërtojmë besim dhe respekt të ndërsjellë.

Nxënësi është qendër e përpjekjeve dhe angazhimeve tona.

I jemi përkushtuar njeriut të ri, me dëshirë që t'u sigurojmë kushte cilësore për punë identike me ato të cilat i kanë edhe nxënësit nga vendet e zhvilluara evropiane. Për realizim të këtij misioni në plan është shkëmbimi i përvojave me shkollat e rajonit dhe më gjerë, nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me vizita dhe shkëmbim të përvojave mes mësimitdhënësve dhe nxënësve të shkollave të vëllazëruara evropiane.

2. VIZIONI

Të krijojmë mjedis të sigurt dhe të disiplinuar, ku mësimi do të jetë modern, efikas, cilësor dhe i përshtatur për nevojat dhe interesat e nxënësve dhe aftësitë dhe nevojat e tyre individuale.

Njohuritë dhe aftësitë e fituara të jenë të qëndrueshme dhe të jenë në gjendje të aplikojnë në arsim dhe zbatimin e detyrave të mëtejme, në hap me informacion të avancuar teknologjik. Shkolla ofron mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit në maksimum për të përdorur kapacitetet e tyre për të fituar njohuri, aftësi dhe shkathtësi që janë të nevojshme për funksionimin e përditshëm dhe arsimimit të mëtejshëm. Në të njëjtën kohë, arsimi synon të rrisë ndërgjegjësimin e të drejtave, obligimeve dhe respektit të ndërsjellë, pavarësisht nga gjinia, feja apo etniteti si të ndërgjegjshëm për mjedisin dhe të etur për veprim dhe vullnet për një ndryshim afatgjatë të qëndrueshëm në qëndrimin ndaj mjedisit.

3. „Lessons Learned“ – Përvojat tashmë të mësuara / të fituara

Ndryshimet në çdo aspekt të sistemit modern arsimor shpejt dhe me guxim i ndjekim dhe në vazhdimësi i zbatojmë në të gjitha fushat e punës sonë.

I përcjellim dhe i zbatojmë ndryshimet në Planin dhe Programin mësimor, njohuritë e reja të fituara dhe zbatimi i procesit arsimor dhe jashtëshkollor të shkollës sonë, janë prioriteti ynë;

Gjithmonë përqipemi që nxënësit të jenë në qendër të vëmendjes sonë;

Janë realizuar trajnime dhe seminare të brendshme dhe të jashtme për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve etj.

Shkolla vitin e kaluar shkollor e ka zbatuar me sukses dhe e ka realizuar programin e Projektit për integrimin ndëretnik në arsim. Stafi i arsimtarëve përmes shpërndarjes nga anëtarët e SIT - it (ekipi për Integrimin ndëretnik në arsim) është përmirësuar vazhdimisht me njohuri dhe aftësi që të jetë në gjendje në të ardhmen të realizojë me sukses këtë program. Për këtë vit presim certifikimin e arsimtarëve për zbatimin e këtij programi.

Të gjithë arsimtarët të zbatojnë eko-përmbajtje në programet mësimore.

Mësimdhënësit zbatojnë TIK në fushat e tyre programore në përputhshmëri me Planin dhe Programin në korniza të kushteve dhe mundësive në shkollë.

"Dallimet nuk mund të jenë pengesë për zhvillimin e shoqërisë, dallimet mund të jenë vetëm forca lëvizëse, përparimi i shkollës, komunës, por në këtë mënyrë edhe të shoqërisë"

Shkolla me sukses e zbaton programin e Projektit për integrimin ndëretnik në arsim. Në vitin e ardhshëm kemi në plan të zgjerojmë bashkëpunimin dhe të krijojmë partneritet me shkollat që kemi qenë partner deri më tani, realizuam dhe do të realizojmë realicione partneriteti edhe me shkollat tjera jashtë kufijve të vendit tonë, nëpërmjet programes ERAZMUS +. Qëllimi i këtij bashkëpunimi do të jetë realizimi i projekteve të përbashkëta ndërkuftare të shkollave dhe shkëmbimi i përvojave mes nxënësve dhe mësimitdhënësve. Kjo do t'u mundësojë nxënësve tanë të njohin nga afër kulturën, mentalitetin, zakonet dhe gjuhën e vendit tjetër, por gjithashtu për të prezantuar kulturën dhe traditat e vendit të tyre. Agjenda e projekteve të tilla të përbashkëta do të realizonin aktivitetet e mëposhtme:

- Vizita në shkollat partnere, vizita e organizimit të orëve të përbashkëta
- Organizimi i shfaqjeve të përbashkëta në të cilat do të prezantohet muzika dhe folklori i të dy vendeve
- Vizita e monumenteve të rëndësishme kulturore dhe historike
- Përgatitja e ushqimeve tradicionale, vizita e restorantit kombëtar etj.

4. Fusha e ndryshimeve, prioriteteve dhe qëllimeve

Motoja e shkollës: “Me dituri deri në sukses”

Procesi i përcaktimit të fushës së ndryshimeve në shkollë është vendimtar për miratimin e Programit për zhvillimin e shkollës. Në përpunimin e këtij Programi vjetor ndikim më të madh ka patur:

- Vetëevaluimi i shkollës;
- Plani i zhvillimit;
- Rekomandimet e Këshillit të shkollës;
- Rekomandimet e ISHA;
- Këshillat nga BZHA

Ekipi shkollor për përpilim të Programit të shkollës është përcaktuar për përcjellje të këtyre prioriteteve hulumtuese, edhe atë:

Nga qëllimet strategjike të shkollës, prioritetet, mundësitë, nevojat e nxënësve dhe të punësuarve në shkollë, i përcaktuam nevojat dhe ndryshimet në shkollë. U përpoqëm t'i përcaktojmë kërkesat prioritare të cilat do të jenë të realizueshme dhe janë në kornizat e mundësive tona.

PRIORITETI I

*** Përmirësimi i infrastrukturës së shkollës**

QËLLIMET ZHVILLIMORE

- Rikonstruimi i sallës sportive dhe garderobave dhe ndërimi i poqëve elektrike në sallën sportive
- Instalimi i ashensorit për fëmijët me nevoja të veçanta
- Zgjerimi i 8 klasave për shkak të rritjes së numrit të nxënësve

PRIORITETI II

***Përmirësimi i burimeve për kryerjen e mësimdhënies cilësore**

QËLLIMET ZHVILLIMORE

- Pajisja e kabineteve (klasave) me tabela smart
- Pajisja e kabinetit të informatikës me kompjuterë, internet dhe pajisje moderne teknologjike
- Sigurimi i laptopëve për stafin e mësimdhënësve

PRIORITETI III

***Përmirësimi dhe modernizimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet trajnimit të mësuesve**

QËLLIMET ZHVILLIMORE

- Përfshirja dhe qasjet në mësimdhënie, për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe me aftësi të kufizuara
- Të mësuarit përmes kërkimit, punës me projekte dhe zgjidhjes së problemeve
- Aplikimi i qasjeve inovative ndërvepruese në mësimdhënie

Koordinator – Ana Markovska

Anëtarë – Elena Stojmenova, Ajnur Aliju, Fatmire Meça, Majlinda Curri

KALENDARI PËR VITIN SHKOLLOR 2024/2025

GJYSMËVJETORI I PARË

2024

Shtator							Tetor							Nëntor							Dhjetor										
Ha	Ma	Mr	Ej	Pr	Sh	D	Ha	Ma	Mr	Ej	Pr	Sh	D	Ha	Ma	Mr	Ej	Pr	Sh	D	Ha	Ma	Mr	Ej	Pr	Sh	D				
35				1	2	3	39						1	44		1	2	3	4	5	48				1	2	3				
36	4	5	6	7	8	9	10	40	2	3	4	5	6	7	8	45	6	7	8	9	10	11	12	49	4	5	6	7	8	9	10
37	11	12	13	14	15	16	17	41	9	10	11	12	13	14	15	46	13	14	15	16	17	18	19	50	11	12	13	14	15	16	17
38	18	19	20	21	22	23	24	42	16	17	18	19	20	21	22	47	20	21	22	23	24	25	26	51	18	19	20	21	22	23	24
39	25	26	27	28	29	30	43	23	24	25	26	27	28	29	48	27	28	29	30	52	25	26	27	28	29	30	31				
							44	30	31																						

GJYSMËVJETORI I DYTË

2025

Janar							Shkurt							Mars							Prill										
Ha	Ma	Mr	Ej	Pr	Sh	D	Ha	Ma	Mr	Ej	Pr	Sh	D	Ha	Ma	Mr	Ej	Pr	Sh	D	Ha	Ma	Mr	Ej	Pr	Sh	D				
1	1	2	3	4	5	6	7	5			1	2	3	4	9			1	2	3	14	1	2	3	4	5	6	7			
2	8	9	10	11	12	13	14	6	5	6	7	8	9	10	11	10	4	5	6	7	8	9	10	15	8	9	10	11	12	13	14
3	15	16	17	18	19	20	21	7	12	13	14	15	16	17	18	11	11	12	13	14	15	16	17	16	15	16	17	18	19	20	21
4	22	23	24	25	26	27	28	8	19	20	21	22	23	24	25	12	18	19	20	21	22	23	24	17	22	23	24	25	26	27	28
5	29	30	31					9	26	27	28	29				13	25	26	27	28	29	30	31	18	29	30					
Maj							Qershor																								
Ha	Ma	Mr	Ej	Pr	Sh	D	Ha	Ma	Mr	Ej	Pr	Sh	D																		
18		1	2	3	4	5	22					1	2																		
19	6	7	8	9	10	11	12	23	3	4	5	6	7	8	9																
20	13	14	15	16	17	18	19	24	10	11	12	13	14	15	16																
21	20	21	22	23	24	25	26	25	17	18	19	20	21	22	23																
22	27	28	29	30	31			26	24	25	26	27	28	29	30																

FESTAT SHTETËRORE, FETARE DHE KOMBËTARE


- 8 SHTATORI-DITA E PAVARËSISË SË MAQEDONISË SË VERIUT
- 11 TETORI- DITA E KRYENGRITJES ANTIFASHISTE
- 23 TETORI-DITA E REVOLUCIONIT MAQEDONAS
- 22 NËNTORI-DITA E ALFABETIT SHQIP
- 8 DHJETORI-DITA E SHËN KLIMENTIT TË OHRIT
- 7 MARS-DITA E MËSUESIT SHQIPTAR
- 10 PRILLI-DITA E FITËR BAJRAMIT
- 1 MAJI-DITA E PUNËS
- 6 MAJI-DITA E PASHKËVE ORTODOKSË
- 24 MAJI-DITA E SHËN KIRILIT DHE METODISË
- 16 QERSHORI-DITA E KURBAN BAJRAMIT
- 19 JANAR-DITA E UJIT TË BEKUAR ORTODOKS
- 21 QERSHOR-DITA E SHPIRTIT

VITI SHKOLLOR 2023/2024
 GJYSMËVJETORI I PARË -01.09.2023-29.12.2023
 GJYSMËVJETORI I DYTË- 22.01.2024-17.06.2024
 PUSHIMI DIMËROR-30.12.2023-21.01.2024
 PUSHIMI PRANVEROR-29.04.2024-05.05.2024

Kalendari ekologjik

16 Shtator	Dita boterore per mbrojtjen e mbështjellësit të ozonit	Projekti: Përdorni parfum e jo dezodorans
22 Shtator	Dita ndërkombëtare pa veturave	Organizimi i garave me biçikleta
08 Tetor	Dita ndërkombëtare për zvoglimin e dëmtimit të natyrës	Akcioni – Mbledhja e shisheve të plastikës. Shitja – punime nga plastika
15 Tetor	Dita ndërkombëtare e këmbësorëve	Gara në ecje të shpejtë
16 Tetor	Dita ndërkombëtare e ushqimit	Tregu i ushqimeve tradicionale (vetëqeverisje lokale, prindër)
17 Tetor	Dita ndërkombëtare per arsimimin e të varfërve	Lexim i referatit
08 Nëntor	Dita ndërkombëtare e mjediseve jetësore urbane	Power Point - prezentim, Punim i vizatimeve
29 Dhjetor	Dita ndërkombëtare e biodiversiteteve	Ekspozitë e punimeve nga ana e nxënësve – hulumtim për kafshët dhe bimët që janë të rrezikuara për të mbijetuar
05 Mars	Dita ndërkombëtare e kursimit të energjisë	Eko Këshillit – Analizë: "Zvogëlimi i harxhimeve pas instalimit të sistemit fotovoltaiq – krahasimi me sistemin e vjetër".
22 Mars	Dita ndërkombëtare e kursimit të ujit	Formimi i Ekopatrullës e cila do ta përcjell harxhimin e ujit me mirëmbajtjen e bimëve. Prezentimi i udhëzimeve për kursimin racional të ujit
07 Prill	Dita ndërkombëtare e shëndetit	Leximi i referateve për mbrojtjen shëndetësore të nxënësve
22 Prill	Dita ndërkombëtare e Planetit	Mbajtja e eko sfilatës; Mbajtja e eko garës; Mbajtja e ekpozotës së punimeve ekologjike nga nxënësit
15 Maj	Dita ndërkombëtare e mbrojtjes së klimës	Lexim i referateve për zhvillimin e vetëdijes ekologjike të nxënësve
31 Maj	Dita ndërkombëtare kundër duhanit	Lexim i referatit, punimi i vizatimeve për tematikën përkatëse, krijimtari letrare,
05 Qershor	Dita ndërkombëtare e mbrojtjes së mjedisit natyror	Punimi dhe promovimi i Eko Kodeksit në shkollë. Zgjedhja e eko paraleles më të vetëdijësuar në shkollë
Dita e drurit – dita e aksionit ekologjik të të rinjëve dhe qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut - Ditë jo pune. Dita e aksionit të eko shkollave – realizohet dy herë në vit gjatë tërë vitit shkollor 2024/2025		

7. MËSIMI DHE TË NXËNIT



- **Mësim plotësues dhe shtues**
- **Aktivitete jashtëmësimore**
- **Aktivitete INA**
- **Integrimi i edukimit ekologjik**
- **Arsimi për Shkathhtësitë jetësore**

Mësimi realizohet përmes orëve mësimore. Çdo orë mësimore zgjat 40 minuta (mund të ketë ndryshime vetëm në raste jashtëzakonshme).

Renditja e orëve mësimore sipas lëndëve dhe paraleleve vërtetohet me orarin e orëve (veçmas për mësimin lëndor , veçmas për mësimin klasor).

Shembull nga orari për orët mësimore vendoset në tabelën e shpalljeve në shkollë.

KOHA MËSIMORE (NË DITË)

Në shkollë organizohet mësimi në dy ndrrime. Në një ndrim oraganizohet mësimi për nxënësit e mësimit klasor (klasa e I deri V të arsimit nëntëvjeçar), kurse në ndrimin e dytë për nxënësit prej kl. VI – IX .

Koha mësimore në ndrimin e parë fillon në ora 7:30, kurse për ndrimin e dytë në ora 13:15
Orari i kohës mësimore është dhënë më poshtë

NDRIMI I PARË

1	0730 - 0810
2	0815 - 0855
3	0900 - 0940
4	1000 - 1040
5	1045 - 1125
6	1130 - 1210
7	1215 - 1255

NDRIMI I DYTË

1	1315 - 1355
2	1400 - 1440
3	1500 - 1540
4	1545 - 1625
5	1630 - 1710
6	1715 - 1755
7	1800 - 1840

të

Në fund të vitit shkollor 2023/2024, nxënësve i'u ofruan lëndë zgjedhore për vitin shkollor 2024/2025 dhe sipas anketimit të bërë në shkollë përfshihen këto lëndë zgjedhore:

LËNDET ZGJEDHORE 2024-2025

Lëndët mësimore	Klasat dhe paralelet	Fondi javor	Mësimdhënës
Lëndë e lirë zgjedhore: Poezi -Teatri,art i emocioneve	IV-1,2,3	3 x 2 = 6	Suela Imeri
Lojëra për zgjidhjen e konflikteve/Kam të drejtë	VII-1,2,3,4	4 x 2 = 8	Irjeta Isaki
Etika e religjioneve	VI-1,2,3	3 x 2 = 6	Metush Memedi
Shkathësi për jetë	VIII-3	1 x 2 = 2	
Arsimi teknik	IX – 1,2,3	3 x 2 = 6	Isuf Jusufi
Përpunimi i letrës/ndihma e parë	V – 2	1 x 2 = 2	
Kor dhe orkestër	VI – IX	3+3=6.	Veton Curri
Kreativitete popullore muzikore/Shah	V-1,3,4,5,	4 x 2 = 8	Nehat Curri
Programim	VIII-1,2	2 x 2 = 4	Fakete Fetai

Mësimi plotësues dhe shtues

I

- (1) Mësimi shtues organizohet për nxënësit të cilët arrijnë rezultate në lëndë të caktuar (nxënës të talentuar).
- (2) Mësimin shtues për nxënësit, arsimtari është i obliguar t'ua ofrojë nxënësve, kurse nxënësit vendosin a do t'a ndjekin mësimin shtues.

II

(1) Mësimi plotësues organizohet me nxënësit të cilët në kontinuitet tregojnë rezultate të dobëta në mësim, e veçanërisht nëse:

- Kanë më së paku dy nota të dobëta
- kanë rezultate të dobëta nga lëndë të caktuara mësimore
- mungojnë nga mësimi nga lëndë e caktuar mësimore
- me kërkesë të nxënësit ose prindit , gjegjësisht kujdestarit.

(2) Arsimtari i cili e realizon mësimin sipas lëndës mësimore i obligon nxënësit nga alinea (1) për vizitë të mësimin plotësues , ndërsa për nxënësit nga alinea 2 dhe 3, mësimi plotësues organizohet sipas vlerësimit të arsimtarit

(3) Nxënësi i përcjellur në mësim plotësues në afat një muaj viziton mësim plotësues më së shumti nga dy lëndë mësimore me më së shumti 4 orë mësimore të lëndës mësimore.

(4) Nëse nxënësi nuk i vijon orët nga mësimi plotësues merr mungesa të paarsyeshme.

(5) Për përcjelljen e nxënësit në mësim plotësues arsimtari është i obliguar t'a njoftojë prindin, gjegjësisht kujdestarin.

III

(1) Shkolla fillore më së voni gjer me 20 shtator në vitin vijues duhet të paraqet orarin me mësim plotësues dhe shtues për çdo lëndë, në vend të dukshëm në shkollë dhe të njejtin duhet t'a dorëzojë në Inspektoratin shtetëror për arsim;

(2) Për arsimtarin, i cili pa arsye nuk i realizon orët plotësuese dhe shtuese, në pajtim me ligjin ngritet procedurë për masa disiplinore.

(3) Për kundërvajtje disiplinore, arsimtarit i ipet masë disiplinore me dënim me të holla nga 10% deri më 30% nga shuma mujore e rrogës neto, që është paguar në muajin paraprak, në afat nga tre gjer në gjashtë muaj.

VËREJTJE - Mësimi plotësues dhe shtues realizohet nëpërmjet orëve mësimore që janë të caktuara me orarin shkollor të orëve. Shembull nga orari vendoset në tabelën e lajmërimeve në shkollë dhe dërgohet deri tek Inspektorati shtetëror i arsimit.

PROGRAMET MËSIMORE

PËRDORIMI I PROGRAMEVE MËSIMORE

Programet mësimore për të gjitha lëndët obligative dhe zgjedhore i përgatit Biroja për zhvillimin e arsimit, ndërsa i miraton Ministria e arsimit dhe shkencës.

Në bazë atyre Programeve çdo arsimtar klasor dhe lëndor përgatit Planprogramin mësimor për çdo lëndë sipas të cilit e realizon mësimin.

Për realizimin e llojeve të ndryshme të mësimit (plotësues dhe shtues) apo aktiviteteve edukativo-arsimore, arsimtarët përgjegjës përgatisin programe adekuate. Gjatë përgatitjes së tyre në mënyrë aktive kyçen aktivet profesionale dhe funksionon puna ekipore.

Shembujt nga programet mësimore ruhen në shkollë edhe ato janë pjesë përbërëse e programit.

PROGRAM PËR PUNË ME NXËNËS TË PRIRUR DHE TË TALENTUAR NË VITIN SHKOLLOR 2024/2025

Mësimdhënësit do të zhvillojnë një plan individual të punës me nxënës të talentuar dhe të prirur nëse janë në dispozicion në klasë dhe do të zbatohen nga shtatori deri në maj gjatë gjithë vitit shkollor. Në të do të jenë të përfshira lëndët për të cilat nxënësi tregon talent, do të parashikohen qëllimet e mësimit, përdorimi i strategjive dhe materialeve didaktike. Përgjegjës për realizimin e planit individual do të jenë mësimdhënësit klasor dhe lëndor në bashkëpunim me puntorët profesional. Secili mësimdhënës posedon mënyra të ndryshme dhe adekuate për vlerësim, me qëllim të përzgjedhjes së fëmijve të moshave të ndryshme dhe prirjeve të ndryshme, gjithëashtu duhet të punohet me plane mësimore të diferencuar, të cilat dukshëm dallojnë prej planeve bazike, të cilat përsëri janë të domosdoshme për të gjithë nxënësit. Ato posedojnë plane mësimore të ndryshëm, numër të ndryshëm të orëve dhe aktivitete tjera, rregullshmëria e të cilit është në përputhje me prirjet dhe moshën e nxënësit. Këto plane mësimore dhe programe nënkuptojnë shkallë të lartë shkencore-teorike në nivel të përmbajtjeve programore, vëllimi i përmbajtjes duhet të jetë specifik dhe i zgjeruara, me një thellësi të madhe në përmbajtjen dhe llojloshmëri të të njëjtave dhe shkallë e lartë e ndërlidhshmërisë të përmbajtjeve programore. Mësimdhënësi nëpërmjet këtyre programeve mësimore për nxënësit e ardhëshëm duhet të jetë në rolin e bashkëpunorit; kurikula e diferencuar e programit mësimor duhet të jetë e ndryshueshme dhe e përshtatshme për mësimdhënësit për gjithësecilin nxënës ose grupe të nxënësve. Nëpërmjet realizimit praktik të planeve programore të diferencuar, gjithëashtu

nëpërmjet realizimit të ushtrimeve të cilat parashikohen për nxënësit e prirur, do të afirmohet tretmane më kualitative pedagogjike për këto nxënës, në rrjedhëshmëri me mësimin e rregulltë, mësimin plotsues dhe aktivitete të lira.

Secili fëmijë në mësim ka të drejtë të përparon aq sa i është ofruar në aftësitë e tija. Dituria dhe aftësitë mund të mësohen, por talentin nxënësi e bartë me vete, por mësimdhënësi nëpërmjet punës së tijë duhet të vlersojë dhe motivojë zhvillimin e tij individual, gjithashtu edhe ta përkrahë nxënësin e talentuar.

Puna me fëmijët e prirur, sot tregon segment të rëndësishëm në sistemin arsimor. Akcenti në programin për punë me fëmijët e prirur vendoset lidhur me metodat dhe format e punës të cilat do të jenë të orientuar drejt mësimin individual dhe shfrytëzimin e informacioneve, zgjerimin e veçorive, formimin e metodave, dije dhe veprime për arrdhje deri te njohuri të reja.

Punën në shkollën tonë do t'a orientojmë drejtë zgjerimit dhe formimit të ekipeve të nxënësve të prirur dhe nxënësve të talentuar nëpërmjet:

- Individualizimit të mësimin me nxënësit
- Grupe në mësim për nxënësit me karakteristika të njejta
- Aktivitete projektive
- Aktivitete të lira
- Organizim i garave, konkurseve dhe aktiviteteve kërkimore
- Organizim i punës kreative

Qëllimet:

- Definim të prirjeve të caktuara
- Të identifikohen nxënësit e prirur në lidhje me talentin
- Të veçohen karakteristikat e fëmijëve të prirur
- Puna praktike me nxënësit e prirur
- Të arrihet ngritja e motivacionit tek nxënësit
- Dhënia e këshillave për prindërit, për fëmijët e tyre të prirur

- Zhvillimi i veçorive të nxënësit për një ose më shumë fusha nëpërmjet zhvillimit të veçorive, interesave, motivimit dhe teknikave për mësim
- Pjesëmarrja në gara
- Zhvillimi i drejtë psiko - fizik i fëmijës së prirur

Detyrat:

- Identifikimi i nxënësve të prirur
- Bashkëpunim iprreth përpilimit të Programeve për punë, me një ose grup të nxënësve
- Punë ekipore për përcjelljen e punës me nxënësit e prirur
- Sigurim i kushteve për realizimin e Programeve (rënditja e orëve, përmbajtja e mësimdhënies, literatura, format për mësim)
- Vlera e rezultateve të arritura tek nxënësit
- Në bazë të identifikimit për nxënësit e prirur, shkolla do të përgatitë Programe individuale dhe të njejtat do t'i realizojnë mësimdhënësit përgjegjës në bashkëpunim me bashkëpunëtorët profesional në shkollë

INKLUZIONI I FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Qëllimet:

- Përfshirja e fëmijëve me NVA në kushte dhe mësim të rregullt, me komunikim dhe funksionim më të mirë, tolerim, mundësi të barabarta në mjedisin shoqëror;
- Përkrahje fleksibile e individualizuar e fëmijëve me NVA nga ana e nxënësve dhe arsimtarëve;
- Pjesëmarrje e rritur dhe aktive në procesin inkluziv dhe arsimor NVA dhe kyqja aktive e prindërve të fëmijëve me nevoja arsimore të veçanta;
- Përpunimi i Planeve arsimore individuale të përshtatura sipas aftësive, nevojave dhe gatishmërisë të çdo nxënësi.

Aktiviteti dhe realizimi i qëllimeve

Aktiviteti i planifikuar programor	Koha e realizimit	Realizues	Për kend ose para kujt do të realizohet	Rezultatet dhe efektet e pritura
1	2	3	4	5
Përgatitja e Programës për punë të ekipit për inkluzionin e fëmijëve me NVA	Gusht	Defektologu me ekipin	Arsimtar dhe prindër	Punë më e suksesshme dhe ndihmë për nxënës dhe arsimtar që kanë nxënës me NVA
Bisedë individuale me prindërit e fëmijëve me NVA të cilët do të kalojnë nga mësimi klasor në lëndor	Gusht	Defektologu , pedagogu, psikologu, drejtori	Për prindërit dhe nxënësit	Bashkëpunim me prindër për shkollim të mëtejshëm të nxënësve me NVA , dorëzimin e mendimit për nga Enti për
Puntori me arsimtarët nga klasa 1- 9 për përgatitjen e PIA (Planeve individuale arsimore) për punë me fëmijët me NVA.	Shtator	Defektologu me ekipin	Arsimtarëve	Trajnim, konsultim dhe sugjerime, për përgatitje të suksesshme të arsimtarëve gjatë përpilimit të PIA

Punëtori me arsimtarët nga klasa e 6 - 9 me temë "Karakteristikat e fëmijëve me NVA"	Nëntor	Defektologu me ekipin	Arsimtarët	Trajnim i arsimtarëve për punë të suksesshme me fëmijët me NVA.
Biseda individuale me prindërit dhe fëmijët me NVA	Gjatë tremujorshit të parë	Defektologu dhe ekipi, pedagogu dhe arsimtarët prej klasës së 1-9	Për prindërit dhe nxënësit	Marveshtje për punë përmes PIA për shkak të zhvillimit të nxënësve me NVA
Pregaditja e Raportit të gjysmëvjetorit parë për punën e ekipit për nxënësit me NVA për vitin shkollor 2023/2024	Janar	Defektologu me ekipin	Për të gjithë të punësuarit	Lajmërim – vetëevaluim për gjysmëvjetorin e parë për realizimin e aktiviteteve të parapara në Programin e ekipit për punë me fëmijë me NVA

Mbledhje me arsimtarët nga klasa 1 – 9. Punë me nxënës të cilët kanë pengesa me të folurit dhe të dëgjuarit	Shkurt	Defektologu me ekipin	Për arsimtarët dhe ekipin profesional	Orientimi i arsimtarëve për identifikimin e suksesshëm dhe punë me nxënës që kanë pengesa me të folurit dhe me dëgjim të dëmtuar, në mësimin e rregullt
Punëtori me arsimtarët prej klasës së 1-9. Punë me nxënës të cilët kanë vështirësi në të mësuarit (disleksia, disgrafia dhe diskalkulia)	Prill	Defektologu me ekipin	Për arsimtarët dhe për prindërit	Orientim i arsimtarëve për identifikim të suksesshëm dhe punë me nxënës të cilët kanë probleme të caktuara në mësim

Pregaditje e Raportit vjetor për vitin shkollor 2024 / 2025 dhe Planit akcional nga ana e ekipit për NVA, për vitin shkollor 2025/2026	Maj / Qershor	Defektologu me ekipin	Për të gjithë të punësuarit	Lajmërim – vetëevaluimi në fund të vitit shkollor për realizimin e aktiviteteve të parapara në programin e ekipit për punë me fëmijë me NVA
--	---------------	-----------------------	-----------------------------	---

Koordinatore - Selime Emini
Anëtarë - Lulzime Islami, Zymrije Abdullai, Sueda Rexhepi, Ferihan Loku,
Sumeja Beqiri,

EDUKIMI EKOLOGJIK NË SISTEMIN ARSIMOR NË SHKOLLË

Qëllimet:

- Implementimi i arsimimit ekologjik në procesin edukativo arsimor, përmirësimi i kushteve për qëndrim dhe punë në shkollë ;
- Shtytja e nxënësve dhe të punësuarve të mendojnë dhe veprojnë ekologjikisht

Detyrat:

- Përbushja e 7- hapave nga Programi për Eko - shkollë;
- Zbatimi i edukimit ekologjik në të gjitha lëndët në mësimin klasor dhe lëndor;
- Përpilimi dhe realizimi i eko projekteve;
- Kremtimi i datave të rëndësishme ekologjike.

Programi i EKO Shkollës për vitin shkollor 2024/2025

AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	BARTËS	KOHA E REALIZIMIT
Formimi i Eko Këshillit	Formimi i Eko Këshillit nga përfaqësues të shkollës, mësimdhënës klasor dhe lëndor, hausmjeshtër, nxënës, përfaqësues nga bashkësia lokale, prindër, përfaqësues nga bashkësia e bizneseve si donator potencial, mediumet.	Drejtori i shkollës, Këshilli Arsimor	Gusht 2024
Analiza e gjendjes së rrethit jetësor	Marrja e pasqyrës reale e gjendjes ekologjike të shkollës në tërësi dhe përcaktimi i prioriteteve të Eko Këshillit	Të punësuar dhe nxënës	Shtator 2024
Prgatitja e Programës dhe rregullores për punë	Identifikimi dhe respektimi i detyrave dhe aktiviteteve të cilat mund të realizohen në rrethin jetësor dhe të përshtaten për shkollën tonë, me qëllim të përmirësimit të kushteve të zhvillimit ekologjik	Eko këshilli, nxënës, përfaqësues nga bashkësia e biznesit	Gusht Shtator 2024
Miratimi i Programës	Prezentimi në Këshillin arsimor dhe miratimi i sajë	Koordinator, Drejtori i shkollës	Shtator 2024
Miratimi i Rregullores	Miratimi i Rregullores në mbledhjen e parë të Eko Këshillit	Eko Këshillit	Shtator 2024
Integrimi i temave Ekologjike ne programën mësimore	Realizimi i pikave të akcionit nga Eko standardet në mësimin e rregullt në të gjithë lëndët gjatë tërë viti shkollor	Drejtori, Koordinator, Arsimtarët, nxënësit	Shtator 2024 Qershor 2025
Njohja e Parlamentit të nxënësve me Programin për integrim të edukimit ekologjik	Formimi i Eko sekcioneve të nxënësve nga klasa e IV – IX të cilët tregojnë interes të posaqëm për ekologji	Drejtori, Koordinator, Arsimtarët, nxënësit	Shtator 2024
Formimi i Eko patrullave	Kyqja e nxënësve nga klasa V-IX në Eko patrulla (Çdo klasë zgjedh nga një përfaqësues dhe patrullat ndrohen çdo javë). Njohja e Eko patrullave me detyrat të cilat duhet t'i realizojnë.	Nxënës, Koordinator dhe arsimtar përgjegjës të eko sekcionit	Shtator 2024

Përpilimi i Eko Kodeksit	Të shkruhet Eko Kodeksi apo Eko bontoni dhe të ekspozohet në tabelën ekologjike.	Nxënës Eko komisioni	Tetor 2024
Shënimi i datave kryesore nga fusha e ekologjisë	Të shënohen datat kryesore nga kjo fushë të cilat janë të shënuara në kalendarin nga shtatori gjer në qershor, kryesisht : 16. shtator – dita botërore për mbrojtje nga mbështjellësi i ozonit 22. shtator – dita evropiane pa vetura 26. shtator - dita botërore për pyje të pastërta 04. tetor - dita botërore për mbrojtjen e kafshëve 22. mars - dita botërore për mbrojtjen e ujit 22. prill - dita botërore e Planetit Tokë 15. maj – Dita Internacionale e akcionit për klimën 05. qershor - dita botërore për mbrojtjen e ambientit jetësor Të sigurohen prezentime, ligjërime dhe ekspozita...	Arsimtarët përmes mësimit të rregullt, Eko sekcionet, të gjithë të punësuarit, prindërit, mediumet dhe vetëqeverisja lokale...	Gjatë tërë vitit shkollor 2024/2025
Aktivitete të veçanta dedikuar ekologjisë	Mirëmbajtja e objektit shkollor dhe rrethit të shëndoshë shkollor Oborr i rregulluar dhe ekologjik në shkollë Kurësimi i ujit Kurësimi i energjisë	Nxënës, Eko Këshilli, Sekcioni i Ekologjisë, Donatorë, Vetëqeverisja lokale dhe mediumet	Gjatë tërë vitit shkollor 2024/25
Përcaktimi i Eko Këndit dhe përcaktimi i Eko Tabelës	Vend i dukshëm në shkollë, foaje ku vizitorët do të mund t'i shohin aktivitetet e Eko shkollës	Drejtor, Koordinator	Tetor 2024
Koncepti mbi energjinë , shfrytëzimin e energjisë dhe ndikimin e saj në kualitetin e jetës së përditshme	Edukimi i nxënësve për energjinë, përmes integrimit të njëjësive mësimore në mësimin e rregullt dhe aktivitetëve jashtëmësimore	Nxënësit, arsimtarët, koordinatorët	Dhjetor 2024 Janar 2025
Koncepti mbi rëndësinë e ujit të shëndetshëm për pije për të	Edukimi i nxënësve përmes integrimit në njësitë mësimore dhe njohja me rëndësinë e burimeve të ujit, vetitë e tij, mënyra e ndotjes dhe mbrojtjes	Nxënësit, arsimtarët, koordinatorët	Mars 2025

gjitha gjallesat, rëndësinë e ruajtjes së burimeve të ujit			
Krijimtari në art fig. me temë: Dëgjoj, shiqoj dhe fotoqafoj ujë	Shprehje kreative me teknika të ndryshme të pikturimit	Nxënës, të punësuar, prindër	Mars 2025
Kontrollimi nga ana e Eko patrullave	Shfrytëzimi racional i ujit për nevojat e hapësirave shkollore, shfrytëzimi i drejt i ujit për higjienën në shkollë	Nxënës, të punësuar	Gjatë tërë vitit shkollor
Vendosja e numrit të nevojshëm të shportave për mbeturina në klasa dhe korridore. Vendosja e kutijave të posaçme për letër dhe plastikë	Shqyrtimi dhe analiza e Eko patrullave për numrin e nevojshëm të shportave të cilat mungojnë nëpër klasa dhe korridore dhe vendosja e tyre. Mbledhja e letrave të vjetra dhe plastikës për reciklimin e tyre	Eko patrulla , koordinatori, nxënësit, të punësuarit, prindërit	Gjatë tërë viti shkollor
Akcioni për mbledhjen dhe selektimin e materijaleve dhe mbeturinave	Përvetësimi i njohurive fillestare për reciklimin e prodhimeve Nxitja e nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve për mbledhjen dhe klasifikimin e prodhimeve në vende të caktuara	Nxënësit, arsimtarët, Personeli teknik	Gjatë tërë vitit shkollor
Rregullimi i klasave	Orientimi i nxënësve për kujdesin e klasës së tyre, nxitja e Eko vetëdijës së tyre me vendosjen e luleve, mirëmbajtjen e pastërtisë...	Nxënësit, Udhëheqësit klasor	Gjatë tërë vitit shkollor
Kontrollimi i Eko patrullës	Vlerësimi për pastërtinë e klasave dhe ndarja e çmimit për pjesën më gjelbëruar dhe shënimi në Eko tabelë pas analizës në fund të çdo muaji	Drejtor, Koordinator	Në fund të çdo muaji gjatë vitit shkollor
Aktivitetet në oborin dhe rrethin shkollor	Mbjellja, ujitja, gropimi, rregullimi i bimëve dhe drunjëve në rrethinën e shkollës	Eko sekcioni, Eko këshilli , të punësuar, donatorë	E organizuar gjatë tërë vitit
Mësim në natyrë dhe organizim i pikniqeve me karakter edukativo arsimor ekologjik	Tek nxënësit të zhvillohet qëndrim i drejtë ndaj natyrës; Mbledhja e materijaleve, fotografi...	Arsimtarët, nxënësit, prindërit	Sipas Planit mësimor
Promovimi i aktiviteteve tona në web faqen e shkollës	Promovimi i të gjitha aktiviteteve të Eko shkollës në web faqen tonë	Arsimtari përgjegjës për dizajnin e faqes	Gjatë tërë vitit shkollor

	Azhurimi i vazhdueshëm i informacioneve, foto dhe aktivitete	ENPT (Ekipi i nxënësve për përkrahje teknike)	
Evaluimi i arritjeve	Grumbullimi i informatave për përparimin e aktiviteteve në shkollë dhe fitimi i rezultateve për mundësinë e përshtatjes së Programës për vitin e ardhëshëm shkollor	Nxënësit, Eko Këshilli, Eko patrullat dhe gjithë subjektët në shkollë	Gjatë tërë vitit shkollor

Arsimtarët përgjegjës: Halim Jashari, Fuada Adili, Vjollca Rexhepi, Faton Curri, Sueda Rexhepi, Refik Bruti, Ramiz Dema, personeli teknik

8. NOTIM, PERCJELLJE DHE VLERËSIM

Ekipi për analizë, percjellje dhe mbështetje

- Qellimet :**
- Zhvillimi profesional i arsimtareve;
 - Përparimi i vlerësimit objektiv dhe vlerësimi i vazhdueshëm;
 - Cilësitë më të larta në arritjet e nxënësve

Aktivite per realizimin e qëlimeve

Aktivitetet e planifikuara programore	Koha e realizimit	Realizues	Për cilin dhe para kujt do te realizohet	Qellimet dhe efektet qe do te arrihen
1	2	3	4	5
Sjellje e programit për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të nxënësve dhe arsimtarëve	Gusht	Ekipi për percjellje dhe vlerësim	Për shkollën dhe arsimtarët	Aplikimi i një sërë aktiviteteve nga arsimtarët për të përmirësuar përparimin e nxënësit

Vizitë në orë prej klasës së I - IX	Vazhdimisht gjatë gjithë vitit	Drejtori, psikologu, pedagogu dhe defektologu	për mësimitdhënësit prej klasës së 1-9	Përmes pjesëmarrjes në klasa për të udhëzuar mësuesit në përfitimet që janë vërejtur gjatë orës dhe lëshimet. Dhënia e udhëzimeve mbi masat për të eliminuar lëshimet për të përmirësuar procesin mësimor
Mbajtja e prezantimeve në perpilimin e pyetjeve sipas Taksonomisë së Blumit me arsimtarët fillestarë	Nëntor	Mësimitdhënësit e trajnuar dhe arsimtarët prej klasës së 1-9	për mësimitdhënësit prej klasës së 1-9	Njohja e arsimtarëve me pyetje me më shumë zgjidhje ne bazë të Taksonomisë së Blumit

Realizimin e një trajnimi për përgatitjen e test pyetjeve me më shumë zgjidhje	Dhjetor	Mësimitdhënësit e trajnuar klases se 1-9	për mësimitdhënësit prej klasës së 1-9	Te aftësohen arsimtarët për të përgatitur pyetje të sakta me më shumë zgjidhje
Prezentimi i suksesit të nxënësve në tremujorin e parë në vitin shkollor 2024/2025 sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike prej klasës së 4-9	Tetor	Ekipi për ndjekje dhe vlerësim të rezultateve sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike	për mësimitdhënësit prej klasës së 1-9	Te konstatohet sukcesi i nxënësve prej klases 4-9, sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike në tremujorin e parë të vitit shkollor 2024/2025 Marrja e masave për përmirësim aty ku është e nevojshme.
Ndjekja dhe analizimi i testeve të zbatuar, të përpunuara sipas Taksonomisë së Blumit	Janar dhe Maj	Mësimitdhënësit e trajnuar prej klasës së 1-9	për mësimitdhënësit prej klasës së 1-9	Nëpërmjet analizave të testeve dhe pyetjeve të parashtruara nga ana e trajnuesve për të njohur mësimitdhënësit se në çfarë

dhe zgjidhje te shumefishte				mënyre duhet parashtruar pyetjet
Analiza dhe prezentimi i suksesit të gjysmëvjetorit të parë për nxënësit në vitin shkollor 2024/2025 sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike prej klasës së 4-9	Janar dhe Shkurt	Ekipi për ndjekje dhe vlerësim të rezultateve sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike	për mësimdhënësit prej klasës së 1-9	Konstatimi i gjendjes në bazë të analizave
